

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtari Misin Frangu me sek.juridike Ardita Tasholli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj rr "[REDAKTUAR]", të cilin me autorizim e përfaqëson av. [REDAKTUAR] kundër të paditurit [REDAKTUAR] ish nga Ferizaj, tani me vendbanim të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDAKTUAR] nga Ferizaj, baza e kontestit vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 8000 €, e pas mbajtjes në seancës gjyqësore me datën 08.06.2016, shpall këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj rr "[REDAKTUAR]", dhe i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale-njësin me nr.P-72217092-00331-6, në vendin e quajtur "Ara te Dardha", me sipërfaqe 54 m2, e evidentuar në certifikatën mbi pronësinë UL-72217092-00095, Zona Kadastrale Ferizaj në bazë të shitblerjes dhe mbajtëses.

DETYROHET i padituri [REDAKTUAR] ish nga Ferizaj, tani me vendbanim të panjohur, të i'a njohin të drejtën e pronësisë paditësit [REDAKTUAR] dhe të durojnë që ngastra e lartpërmendur të regjistrohet në emër të tij.

DETYROHET Drejtoria për Kadastër, Pronësi dhe Gjeodezi në Ferizaj, që të bëjë ndryshimin në bazë të këtij aktgjykimi.

II. Shpenzimet e procedurës do ti heqë paditësi, taksen për Aktgjykim në shumën prej 50 €, dhe taksen për padi 25 €.

A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi me shkrim pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj me datën 25.08.2015, me bazë juridike vërtetimi i pronësisë në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes.

Përfaqësuesi i paditësit av. [REDAKTUAR] ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe në veçanti ka theksuar se paditësi nga i padituri me dt.06.04.1964, në bazë të kontratës të shkruar e ka blerë palujtshmerine ngastrën 00331-6 në sip. prej 54 m2, ZK. Ferizaj, paditësi i ka paguar në tërësi çmimin e kontraktuar të shitblerjes dhe i padituri i ka dorëzuar paditësit në posedim dhe shfrytëzim të qetë.

I ka propozuar gjykatës që të administroj provat : Kontratën e shitblerjes, fletën poseduese, kopjen e planin e viti 1972, fletëparaqitjen dhe regjistrimin e ndërrimeve në kadastër si dhe të bëhet shikimi në vend të ngjarjes së bashku me ekspertin e gjeodezisë. Përfaqësuesi i paditësit me autorizim av. [REDAKTUAR] ka deklaruar se Konstatimet dhe mendimet e prezantuara në ekspertizën e gjeodetit [REDAKTUAR] te dt.27.05.2016, me matjet dhe skicimet e ngastrës lëndore 00331-6, nuk e kontestoj, sepse përkon edhe me dëshmi dhe prova të tjera të cilat janë bashkangjitur padisë dhe kërkesë padisë, dhe ka deklaruar se Vlera e kontestit - e kësaj palujtshmerie është 8.000 €.

Përfaqësuesi i përkohshëm i caktuar me aktvendim C.nr.495/15, të dt.25.03.2016, av. [REDAKTUAR] ka deklaruar tani për tani e kontestoj padinë dhe kërkesë padinë e paditësit. Nuk kam informacione dhe nuk kam mundur të vë kontaktin me të paditurin interesat e të cilit i mbroj me aktvendim të kësaj gjykate si përfaqësuesi i përkohshëm i tij. Më detajisht nuk kam njohuri se ngastra kadastrale e cila është objekt i shqyrtimit në këtë çështje juridike-civile, se kur është bërë shitblerja në mes të dy ndrgjygjesëve, andaj gjykata ti i verifikoj thëniet e të autorizuarit të paditësi si dhe provat në dosjen e lëndës. Në bazë të konstatimit të ekspertit është bërë ingjizimi i ngastrës kadastrale që është objekt i shqyrtimit, konsideroj se kjo gjendje është reale dhe i përgjigjet gjendjes në tërësi. Për këtë arsye nuk kam vërejtje dhe nuk e kontestoj mendimin e ekspertit.

Gjykata kishte lexuar dhe shtjelluar prova që gjenden në shkresat e lëndës që ishin lexuar Kontrata e datës, 06.04.1964, kopja e planit e viti 1972, Çertifikata e pronës e datës 25.05.2016, ekspertizën e ekspertit gjeodet [REDAKTUAR] e punuar me datën.27.05.2016, përgjigjen nga ana e AKP-së me nr. të referencës 00424/16/Vd, e datës 08.04.2016. përgjigja nga kërkesa e Memorandumit Zyrtare Policia e Kosovës- Drejtoria Rajonale e Policisë Stacioni Policore në Ferizaj me nr. 04/1-05 F-366/16e e dt.06.04.2016

Përfaqësuesi i paditësit me autorizim av. [REDAKTUAR] ne fjalën përfundimtare ka deklaruar, me provat e administruara në shqyrtimin kryesorë vërtetohen faktet se paditësi në vitin 1964, në bazë të veprimit juridik- kontratës në formë të shkruar ka blerë nga i padituri patundshmërinë lëndore ngastrën nr.00331-6 me sipërfaqe prej 54 m2, ZK Ferizaj, për të cilën e ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes dhe në të cilën ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim duke i dorëzuar pronarit tani i paditurit, paditësi patundshmërinë lëndore e shfrytëzon që nga viti 1964, të cilën ja ka bashkangjitur sipërfaqen e kësaj ngastre pronës së tij dhe të cilën e ka rrethuar me rrethojë dhe e shfrytëzon pa vërejtje ma shume se 20 vite , në bazë të fakteve të vërtetuar, rezulton se paditësi i përmbush të gjitha kushtet që të konsiderohet pronar i ngastrën lëndore në të cilin ka hyrë edhe me veprim juridik, e shfrytëzon ma shume se 20 vite, dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje dhe ndërprerje të posedim të saj, e që me nenin 28 par.2 të Ligjit themelorë mbi marrëdhëniet pronësore juridike te RSFJ-së, trajtohet se është pronar i ngastrës se cekur, i propozoj gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar dhe të vërteton se i paditësi është pronar juridik i ngastrës lëndore.

Përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem pranë theksimeve të cekura ne shqyrtimin kryesorë të sotshëm.

Në bazë të provave që gjykata i administroj në shqyrtimin kryesor mendoj se ka arsye për të besuar e njëkohësisht për të vërtetuar se shitblerja në mes palëve kontraktuese ka ndodhur në vitin 1964, dhe se prej ati viti e gjerë më tani ngastrën kadastrale që është objekt kontesti ka pasur në shqyrtim dhe posedim paditësi i ka propozuar gjykatës që në bazë të provave që janë administruara ne këtë çështje juridike civile të merr aktgjykim meritor.

Gjykata duke u bazuar në neni 8 të LPK-së, veçoj provat veç e veç. Certifikatën e pronës për ngastrën kadastrale-njësinë nr.P-72217092-00331-6, ZK.Ferizaj, dëshmojnë se padia përputhet plotësisht në subjektin si palë kontestuese.

Ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë tregon kompatibilitetin-përputhshmërinë e kërkesëpadisë në aspektin formal me gjendjen reale dhe faktike në teren si dhe gjendjen aktuale, mbi shfrytëzimin e kësaj ngastre kadastrale dhe kontestuese deri me tani.

Gjykata për përfaqësues të përkohshëm i kishte caktuar avokatin [redacted] nga Ferizaj. Gjykata nga Stacioni Policor në Ferizaj kishte kërkuar me shkrim që të verifikohet adresa e të padituri, por përgjigja kishte rezultuar negative.

Gjithashtu gjykata kishte kërkuar edhe nga Agjencioni Kosovar i Pronës që të na njoftoj lidhur me ndonjë kërkesë eventuale pranë Agjencionit të ndonjë pretendues të pronës se zhvillohet apo nuk zhvillohet, ndonjë kontest për ngastrën e lartshënuar. Dhe nga ky Agjencion ishte informuar se për ngastrën kontestuese e lartpërmendur nuk kishte paraqitur asnjë kërkesë as nga personat fizik por as nga ata juridik.

Kërkesa për verifikimin e adresës se të paditurit dhe përgjigja nga stacioni policor në Ferizaj e arsyeton vendimin e Gjykatës për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin sikurse që e arsyeton procedimin e kësaj lënde dhe vendosjen e përgjigjeja me nr.Ref.00294/16/vd e datës 24.03.2016, nga AKP-ja se vërtete për këtë ngastër kadastrale askush nga personat fizik dhe e as nga ata juridik nuk ka paraqitur kërkesë lidhur me këtë ngastër kontestuese.

Gjykata ka vërtetuar se në mes paditësit [redacted] dhe të paditurit [redacted] ka ekzistuar raport juridik i cili është i lidhur në formë e shkruar ka prodhuar efekt juridik, me faktin se kishte ndodhur transaksioni në mes tyre si shitës dhe blerës. Këtë raport juridik paditësi e materializon duke hy në posedim të pa ndërprerë dhe të pa penguar nga askush që nga viti 1979 ku dhe kishte paguar çmimin në tërësi.

Gjykata nga e drejta material konstaton se janë përmbushur kushtet nga neni 18 i LMD-së si dhe nga neni 36 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore, si dhe neni 28 par.4 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike i shpalle në G.Zyrtare të RSFJ" nr.6/80 dhe 37/90 të cilin raport edhe sot e legalizon dhe legjitimon neni 40 par. 1 i Ligjit për të Drejtat Sendore nr.03/L-154 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj Gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme duke qenë i pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës do ti bartë paditësi [redacted] neni 467.1 i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

C.nr. 495/2015 Më 06.06.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO

Sek. Juridike
Ardita Tasho



Gjyqtari
Misin Frangu

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.